

AKT I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“FIGARO” SH.P. K

Sot, më 21/01/2025 në Tiranë, palët e mëposhtme (referuar në tekst kolektivisht si “**Ortakët Themelues**”, ose individualisht secili si “**Ortaku**”) bien dakord të miratojnë Aktin e Themelimit, si më poshtë:

1. **Mario Kola**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 18.03.1998, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal J80318050N.
2. **Erald Skura** shtetas shqiptar, lindur në Burrel më 30.10.1994, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal J41030037M.

I. Themelimi

1. Ortakët themelues vendosën për themelimin e shoqërisë “**FIGARO**” Sh.p.k, nje shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar (“**Shoqëria**”).
2. Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në adresën: Rruga Bardhok Biba, Njësia Administrative nr. 9, kati përdhe, përballë hotel Freddy, 1016, Tiranë, Shqipëri.
3. Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pacaktuar.

II. Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

- Shërbim restoranti, bar kafe.

III. Statuti

Ortakët Themelues me anë të kësaj deklarë miratimin e Statutit të Shoqërisë.

IV. Kapitali Themeltar



1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është 10,000 (pesë milion) Lekë. Cdo ortak zotëron 1 (një) kuotë me një vlerë të përgjithshme nominale në proporcion me kontributin e tij në kapitalin e Shoqërisë

Ortakët zotërojnë kapitalin si më poshtë:

- **Mario Kola** – 50 % 5,000 (pesë mijë) Lekë
- **Erald Skura** – 50% 5,000 (pesë mijë) Lekë

2. Kuotat janë të zakonshme dhe ortaku ka të drejta votimi *proporcionale* me vlerën nominale të çdo kuote.
3. Kapitali i Shoqërisë paguhet plotësisht dhe nënshkruhet nga Ortaku Themelues.

V. Administratori


1. Shoqëria menaxhohet nga 1 (një) Administrator i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë te çdo pale e tretë. Numri i Administratorëve mund të ndryshohet nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Administratori do të jetë përgjegjës për punët e përditshme të Shoqërisë, duke iu nënshtruar kufizimeve të parashikuara në Statut, ligjin e aplikueshëm dhe nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të riemërohet. Administratori i parë i Shoqërisë është:

Mario Kola, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 18.03.1998, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal J80318050N.

Akti i Themelimit është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Akti i Themelimit është hartuar në pajtim me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ortakët e Shoqërisë

Mario Kola



Erald Skura

ERALD SKURA



STATUT I SHOQERISE
“FIGARO” SH.P.K.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisëorganizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, më 21/01/2025, në Tiranë, për sa mëposhtë:

Mario Kola, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 18.03.1998, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal J80318050N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Erald Skura, shtetas shqiptar, lindur në Burrel, më 30.10.1994, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal J41030037M, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

ne përputhje me LigjinNr.9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe melegjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratoi këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

**Data e Themelimit, Emri dhe
Themeluesit**

Sot, më 21/01/2025, themeluesët e mësipërm, vendosë të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar “**FIGARO**” SH.P.K.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:



- Shërbim restoranti, bar kafe.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e ***pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.***

Neni 4
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Bardhok Biba, Njësia Administrative nr. 9, 1016, kati përdhe, përballë hotel Freddy ,Tiranë, Shqipëri.

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II
Kapitali

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.

Cdo ortak zotëron 1 (një) kuotë me një vlerë të përgjithshme nominale në proporcion me kontributin e cdo ortaku në kapitalin e Shoqërisë

Ortakët zotërojnë kapitalin si më poshtë:

Z Mario Kola është zoterues i 1 kuote me vlerë 5,000 (pesë mijë) lekë, e cila përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Z Erald Skura është zoterues i 1 kuote me vlerë 5,000 (pesë mijë) lekë, e cila përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kontributi është në para.

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit



Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. Çdo disponim në favor të një pale të tretë nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet të gjallëve duhet të bëhet në formë noteriale dhe të regjistrohet. Në rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit me kundërshtpërblim, ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë përçështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike.
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortaktjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Per sa kohe që kapitali themeltar i Shoqërisë zotërohet nga një ortak i vetëm, ky i fundit do të ushtrojë kompetencat e Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve.



Neni 9
Mënyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblesë se
Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendimetë vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10
Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 70% (përqind) të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare



nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Neni 12

Përgjithshme nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Organi Administrativ mund të kryejë në mënyrë autonome të gjitha aktet e administrimit të zakonshëm, ndërsa për veprimet e jashtëzakonshme është gjithmonë i nevojshëm vendimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, si dhe për të gjitha vendimet për të cilat është marrë vendimi paraprak i Asamblesë së Ortakëve që kërkohet me ligj. Si shembull dhe pa u kufizuar në të, aktet që lidhen me kompanitë ose degët e kompanive, fabrikave dhe makinerive që nuk janë të kufizuara në pajisje shtesë ose pjesë këmbimi, duke marrë hua bankare, akte dhe kontrata në lidhje me pronën, etj., konsiderohen të jenë akte të administrimit të jashtëzakonshëm. Mbledhja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë kufizime më të rrepta në operacionet e tyre në procesverbalin e emërimit të administratorëve, ndoshta edhe shprehimisht përcaktimin e kufirit në vlerë të veprimeve të zakonshme nga ato të administrimit të jashtëzakonshëm.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi:

Mario Kola, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 18.03.1998, mbajtës i Letërnjoftimit, me nr. Personal J80318050N.

Kreu IV
Viti financiar-ekspertet

Neni 14
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15
Ekspertët

Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 16
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrine likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri ne likuidim e sipër”.



Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftës isë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 17

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 18

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Mosmarrëveshjet


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt u hartua në gjuhën Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortakët themelues si vijon:

ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“FIGARO” SH.P. K

Mario Kola



Erald Skura

ERALD SKURA

